



Pranuar / Dorezuar Primjena / Prizdato Received / Delivery	14.10.2022	2	viti god year
Organ / Njesia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKM/MSJ/K	6237	2022	1/7



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.718/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Jeton Koca-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.718/2022 datës 19.08.2022, të parashtruar nga ankuesi \_\_\_\_\_ përmes avokatit të autorizuar \_\_\_\_\_ me adresë: \_\_\_\_\_ në Komunën e Prishtinës, kundër Vendimit me numër:026 të datës 10.08.2022 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës, në çështjen juridike "Masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 14.10.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.718/2022 e datës 19.08.2020 e parashtruar nga ankuesi \_\_\_\_\_

II. MBETEN në fuqi Vendimi me numër:026 i Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës i datës 09.08.2022 si dhe Vendimi me numër:026 i Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës i datës 10.08.2022

A r s y e t i m

Ankuesit, \_\_\_\_\_ i cili sipas shkresave të lëndës është i punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës, Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës përmes vendimit me numër:026 të datës 10.08.2022 i ka shqiptuar masën disiplinore "Largim nga Shërbimi Civil", me arsyetimin si i njëjti ka bërë shkelje të rënda të detyrave të punës.

Ankuesi, kundër Vendimit me numër:026 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës të datës 10.08.2022, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për

Shërbimin Civil të Kosovës me datë 19.08.2022, me pretendimet ankimore se Komisioni Disiplinor me rastin e nxjerrjes së vendimit të datës 09.08.2022 përmes të cilit e ka shfuqizuar Vendimin paraprak të datës 06.12.2021 të Komisionit Disiplinor dhe ka vazhduar inicimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit sipas shkresës së datës 26.10.2021 të Zëvendës Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 57 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe në kundërshtim edhe me nenin 48 dhe 52 i të njëjtit ligj.

Po ashtu, ankuesi pretendon se ndërlidhur me rastin e inicimit të procedurës disiplinore ndaj tij sipas shkresës së datës 26.10.2021 të Zëvendës Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës, tani më është rast i vendosur ngase Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës përmes Vendimit me numër A.nr.1232/2021 të datës 24.02.2022, kishte shfuqizuar Vendimin e datës e Ministres së Ministrisë së Drejtësisë të datës 02.12.2021 për të njëjtat shkelje disiplinore sikurse potencohen edhe në shkresën e inicimit të procedurës disiplinore sipas shkresës së datës 26.10.2021 të Zëvendës Drejtorit të Përgjithshëm.

Ankuesi, ndërlidhur me masën disiplinore "*Largim nga Shërbimi Civil*" të shqiptuar përmes Vendimit me numër:026 të datës 10.08.2022, pretendon se Komisioni Disiplinor nuk ka pasur kompetencë lëndore, pasi që kompetent për trajtimin e rastit të tij është Këshilli Shtetëror për Vlerësim dhe Cilësi në kuptim të nenit 49 paragrafi 2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, pasi që ankuesi nuk kohën kur supozohet se ka kryer shkelje disiplinore e ka pasur statusin e nëpunësit civil të Kategorisë së Lartë Drejtuese, po ashtu ankuesi pretendon se masa disiplinore i është shqiptuar në kundërshtim me dispozitat e nenit 45, nenit 47 paragraf 1 nën paragrafi 1.4, neni 48 paragrafi 6, neni 49 paragrafi 2 dhe nenit 50 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik.

Ankuesi në Këshill ka parashtruar dy ankesa me datë 19.08.2022, njëra e cila është protokolluar me numër:4817/2022 dhe është regjistruar me numër A.nr.717/2022 kundër Vendimit me numër:026 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës të datës 10.08.2022 për shqiptimin e masës disiplinore, ndërsa ankesa tjetra është protokolluar me numër:4818/2022 e cila është regjistruar me numër A.nr.718/2022 kundër Vendimit me numër:026 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës të datës 09.08.2022.

Kryetari i Këshillit, sipas kërkesës së Kryetarit të Kolegjit për ankesën A.nr.717/2022 të datës 19.08.2022, ka nxjerrë vendimin e datës 24.08.2022 me numër VK.nr.23/2022 përmes të cilit vendim është bërë bashkimi i ankesave të ankuesit, pra ankesa A.nr.717/2022 është bashkuar në ankesën A.nr.718/2022 pasi që ka qenë ankesa e fundit në renditje, ndërsa dhe objekti i shqyrtimit të kësaj lëndë, gjendja faktike si dhe baza ligjore kanë qenë të njëjta për të dy (2) ankesat.

Po ashtu, Kryetari i Këshillit sipas kërkesës së Kryetarit të Kolegjit me datë 28.09.2022 përmes Vendimit me numër VK.nr.105/2022 i ka vazhduar ankesës A.nr.718/2022 të datës 19.08.2022 afatin vendimmarrës edhe për dhjetë (10) ditë, ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën e a datës 19.08.2022 me numër te protokollit 4817/2022 te parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Autorizimin e datës

02.12.2021; Vendimin me numër:026 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës i datës 10.08.2022; Fletë kthesën me numër evidence: KD.nr.026/10.08.2022; Vendimin mbi deklarin e statusit të zyrtarëve publik i datës 16.06.2021; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë të ankuesit për vitin 2019 i datës 18.12.2019; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë të ankuesit për vitin 2020 i datës 31.12.2020; Përgjigjen në ankesë e datës 05.09.2022 me numër protokolli:5141/2022; Listën me shkresat e lëndës së dërguar me numër:137/ të datës 05.09.2022; Akt emërimit e ankuesit të datës 30.05.2022 me shifër AE.Nr.009/2022; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Drejtor i Qendrës së Paraburgimit Pejë; Vendimin e Komisionit Disiplinor të datës 09.08.2022; Vendimin e Komisionit Disiplinor të datës 06.12.2021; Vërtetimin e datës 05.09.2022 të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Shërbimit Korrektues të Kosovës; Përgjigja e Komisionit Disiplinor e datës 05.09.2022 me numër:666; Raporti i datës 13.10.2022 me numër:01-1690; E-mailin e datës 19.01.2021 dërguar nga S.S për R.R me korrespondencën e bashkangjitur; E-mailin e datës 16.01.2021 dërguar nga S.S për ankuesin me korrespondencën e bashkangjitur; Deklaratën e datës 19.01.2022 nga i burgosuri B.M; Kërkesën e datës 19.01.2021; Kërkesën për transfer e datës 19.01.2022 nga B.S për Drejtorin e Përgjithshëm të SHKK-së; Kërkesën për transfer e datës 19.01.2022 nga A.K për Drejtorin e Përgjithshëm të SHKK-së; Vendimin e datës 20.01.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm të SHKK-së; Vendimin e datës 18.02.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm të SHKK-së; Vendimin për transferim i datës 30.01.2021; Vendimin refuzues të datës 20.01.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm të SHKK-së; Vendimin e datës 12.10.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm të SHKK-së; Njoftimin-Rasti PP/I.nr.13K/2021 të datës 30.09.2021; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2019 i datës 17.12.2019; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2020 i datës 31.12.2020; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 26.08.2022; Ankesën e a datës 19.08.2022 me numër te protokollit 4818/2022 te parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Vendimin e Kryetarit të Këshillit i datës 24.08.2022 me numër VK.Nr.23/2022; Vendimin e Kryetarit të Këshillit i datës 28.09.2022 numër VK.nr.105/2022.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar që ankesa e ankuesit është e pabazuar, sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, në bazë të provave të lëndës të ofruara nga palët në procedurë ka konstatuar se ankuesi marrëdhënien e punës në Shërbimin Korrektues të Kosovës në pozitën "Drejtor i Qendrës së Paraburgimit në Pejë" e ka themeluar mbi bazën e Ligjit Nr.04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale si dhe Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, fillimisht e marrëdhënien e punës e kishte themeluar në vitin 2012 sipas Kontratës se Punës për Kohë të Caktuar të datës 09.03.2012 me afat të caktuar deri me datë 08.03.2017, ndërsa sipas Vendimit të datë 13.03.2015 ishte caktuar si Drejtor i Qendrës së Paraburgimit në Prishtinë deri në skadimin e mandatit të tij sipas kontratës. Pastaj më datë 08.03.2017 i është lëshuar Kontratë Punë për Kohë të Caktuar, për pozitën Drejtor i Qendrës së Paraburgimit në Prishtinë dhe atë nga data 08.03.2017 deri më datë 07.03.2022. Ndërmjet kësaj periudhe me Vendimin Nr.518 të datës 10.04.2019 është transferuar përkohësisht në pozitën Drejtor i Qendrës Korrektuese në Lipjan, pastaj me Vendimin Nr.4398 të datës 24.12.2019 është kthyer në pozitën Drejtor i Qendrës së Paraburgimit në Prishtinë, ndërsa sipas Vendimin me Nr. 1090 të datës 24.09.2021 është transferuar në pozitën Drejtor i Qendrës Korrektuese për të Mitur dhe Femra në Lipjan.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në bazë të shkresave të administruara të lëndës, ka konstatuar se Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës përmes vendimit të datës 06.12.2021 kishte nxjerrë Vendimin numër:026 për përfundimin e procedurës disiplinore të iniciuar ndaj ankuesit [redacted] sipas kërkesës së datës 26.10.2021 nga Zëvendës Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës, me arsyetimin se Ministria e Ministrisë së Drejtësisë përmes Vendimit me numër 160/2021 të datës 02.12.2021 i kishte ndërprerë ankuesit marrëdhënien e punës, ndërsa objekti i shqyrtimit për të cilin kishte filluar procedura disiplinore ishte bërë i pamundur në kuptim të nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit thekson faktin se sikurse inicimi i procedurës disiplinore nga Zëvendës Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës përmes shkresës së datës 26.10.2021, sikurse edhe Vendimi me numër 160/2021 të datës 02.12.2021 i nxjerrë nga Ministria e Ministrisë së Drejtësisë për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së ankuesit [redacted] ishte mbështetur mbi të njëjtën gjetje për shkelje disiplinore, respektivisht ankuesi sipas raportit të datës 13.10.2021 të inspektoratit të Ministrisë së Drejtësisë ishte gjetur përgjegjës për shkelje të rënda disiplinore të përcaktuara me nenin 46 paragrafin 3 nën paragrafi 3.3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrarët Publikë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, thekson faktin se Këshilli me rastin e nxjerrjes së Vendimit A.nr.1232/2021 të datës 24.02.2022 përmes të cilit ishte aprovuar ankesa e ankuesit e datës 30.12.2021 ndërsa ishte shfuqizuar Vendimi me numër 160/2021 i datës 02.12.2021 i Ministres së Ministrisë së Drejtësisë për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së ankuesit, dhe në rastin konkret vendimarrja ishte bazuar vetëm mbi bazën e kompetencës se kush ka të drejtën t'i shqiptojë nëpunësve civil masën disiplinore largim nga shërbimi civil, dhe në rastin konkret Kolegji i Këshillit kishte konstatuar se sipas dispozitave të ligjit material, kjo kompetencë i garantohet Komisionit Disiplinor siç përcaktohet edhe me nenin 48 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrarët Publik.

Lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit se Komisioni Disiplinor me rastin e nxjerrjes së vendimit më Numër:026 të datës 09.08.2022 përmes të cilit e ka shfuqizuar Vendimin numër:026 të datës 06.12.2021 lidhur me përfundimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative neni 57 paragrafi 2 ku përcaktohet se: *"Përpos nëse parashihet ndryshe me ligj, një akt administrativ dobiprurës i ligjshëm, mund të shfuqizohet vetëm nëse shfuqizimi është i domosdoshëm për të parandaluar apo eliminuar një dëmtim serioz të jetës dhe shëndetit të njerëzve apo sigurisë publike, dhe kjo nuk do të mund të bëhet në mënyra tjera që do të cenonin më pak të drejtat apo interesat juridike të fituara të palës"*, Kolegji i Këshillit thekson faktin se pretendim e tilla të palës janë të paqëndrueshme, ngase Komisioni Disiplinor Vendimin numër:026 të datës 06.12.2021 e kishte nxjerrë për shkak të shuarjes së objektit të shqyrtimit, respektivisht Vendimin numër:026 të datës 06.12.2021 i Komisionit Disiplinor nuk i ka njohur palës ndonjë të drejtë për të qenë dobiprurës, rrjedhimisht në rastin konkret Komisionin Disiplinor nuk ishte lëshuar fare në shqyrtimin meritore për të konfirmuar ose jo masën disiplinore ndaj ankuesit respektivisht dispozitat e nenit 57 paragrafi 2 Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative nuk mund të gjejnë aplikim në rastin konkret, andaj Komisioni Disiplinor me rastin e nxjerrjes së Vendimit më numër:026 të datës 09.08.2022 përmes të cilit e ka shfuqizuar

Vendimin numër:026 të datës 06.12.2021 ka vepruar në pajtueshmëri me nenin 57 paragrafi 1 dhe nenin 53 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative me qëllim të ushtrimit të kompetencave dhe përgjegjësi që i garantohen me ligjin material, respektivisht me nenin 48 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ndërsa pretendimi i ankuesit është i pabazuar.

Lidhur me pretendimin e palës ankues se inicimit të procedurës disiplinore ndaj tij sipas shkresës së datës 26.10.2021 të Zëvendës Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës, tani më është rast i vendosur ngase Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës përmes Vendimit me numër A.nr.1232/2021 të datës 24.02.2022, e ka shfuqizuar Vendimin e Ministres së Ministrisë së Drejtësisë të datës 02.12.2021 për të njëjtat shkelje disiplinore sikurse potencohen edhe në shkresën e inicimit të procedurës disiplinore sipas shkresës së datës 26.10.2021 të Zëvendës Drejtorit të Përgjithshëm, janë të paqëndrueshme dhe të pa bazuara ngase Këshilli me rastin e nxjerrjes së Vendimit numër A.nr.1232/2021 të datës 24.02.2022 nuk është lëshuar në shqyrtimi meritior ndërlidhur me kryerjen e shkeljes disiplinore ose jo nga ana e ankuesit, respektivisht Këshilli përmes nxjerrjes së vendim në fjalë ka vlerësuar vetëm kompetencën sa i përket autorizimeve ligjore lidhur më shqiptimin e masës disiplinore "Largim nga Shërbimi Civil" për nëpunësit civil, madje është për tu theksuar fakti se përfaqësuesi i palës Vendimin e Këshillit të datës 24.02.2022 me numër A.nr.1232/2021 e vlerëson si të drejtë dhe të ligjshëm, madje ky konstatim nga i njëjtit shërben si kundër argument për pretendimin e tij ankimor se rasti i ankuesit është i mbyllur për shkeljen e supozuar disiplinore, andaj mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit konstaton se pretendimet e ankuesit janë të pabazuara ngase lidhur me shkeljen disiplinore të ankuesit e konstatuar në raportin e datës 13.10.2021 të Inspektoratit të Ministrisë së Drejtësisë, asnjëherë paraprakisht nuk ka pasur një vendim përfundimtar në procedurë administrative që ka përcaktuar përgjegjësinë apo mos përgjegjësinë, respektivisht kryerjen apo mos kryerjen e shkeljes disiplinore nga ana e ankuesit e përcaktuar si në nenin 46 paragrafin 3 nën paragrafi 3.3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nga rrjedh se pretendimi ankimor i ankuesit është i pabazuar.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit lidhur me pretendimin e palës ankuese, se për shqiptimin ose jo të masës disiplinore ndaj ankuesit kompetent është Komisioni Shtetëror i Vlerësimit i përcaktuar me nenin 49 paragrafi 2 të Ligjit nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik me arsyetimin se ankuesi e ka statusin e nëpunësit civil të kategorisë së lartë drejtuese ndërsa Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës nuk ka pasur kompetencë lëndore për masën e shqiptuar disiplinore, konstaton se janë pretendime të pa qëndrueshme dhe të pa bazuara në ligj, ngase Këshilli me asnjë vendim të tij, respektivisht as me Vendimin e datës 24.02.2022 dhe numër A.nr.1232/2021 nuk ia ka njohtë e as konfirmuar statusin e nëpunësit të kategorisë së lartë drejtuese për ankuesin dhe madje as për pozitën e ngjashme sikurse të tij në kuadër të Shërbimit Korrektues të Kosovës, madje në kuptim të nenit 33 paragrafi 2 në paragrafi 2.1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, në kuadër të Shërbimit Korrektues të Kosovës pozitën e Kategorisë së Lartë Drejtuese e ka Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues, ndërsa ankuesi hynë në kuadër të kategorisë së mesme drejtuese të përcaktuar me nenit 33 paragrafi 2 në paragrafi 2.2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik dhe ky fakt vërtetohet edhe në bazë të përshkrimit e detyrave të punës ngase ankuesi i raporton drejtpërdrejtë Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, konstatimit të gjendjes faktike si dhe shqyrtimit të pretendimeve ankimore të palës ankuesi, ka ardhur në përfundimit se Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës me rastin nxjerrjes së Vendimit të datës 10.08.2022 me numër:026 përmes të cilit ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore "Largim nga Shërbimi Civil", ka vepruar në pajtueshmëri me kompetencën dhe mandatin e tij ligjor të përcaktuar me nenin 48 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, pasi që ka konstatuar faktin ankuesi ka kryer shkelje të rënda disiplinore të përcaktuara me nenin 46 paragrafin 3 nën paragrafi 3.3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë ku përcaktohet se: "Shkelje disiplinore konsiderohen shkelje të detyrave të punës dhe detyrimeve ligjore, duke përfshirë mundësinë e shqiptimit të masave disiplinore. Shkelje të rënda konsiderohen: 3.3. moszbatimi i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale" ngase ankuesi me rastin e realizimit të përcjelljes së të burgosurit B.M nga Institucioni për Prokurorinë Themelore, kishte vepruar në kundërshtim me Rregulloren e Brendshme të Punës Nr.1459 të gjetura këto edhe në Raportin e Inspektoratit të Ministrisë së Drejtësisë të datës 13.10.2022 me numër:01-1690, ndërsa pala me asnjë argument ose provë relevante nuk ka mundur të dëshmojë të kundërtën e kësaj të gjeture.

Duke marr parasysh të gjeturat dhe konstatimet e dhëna në arsyetimin e këtij vendimi, Kolegji i Këshillit konstaton se Komisioni Disiplinor me rastin e shqiptimit të masës disiplinore ndaj ankuesit "Largim nga Shërbimi Civil" ka vepruar në pajtueshmëri me nenin 48 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë ndërlidhur me nenin 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 i të njëjti ligj, pasi që ankuesi është gjetur përgjegjës për shkelje të rënda të detyrave të punës të përcaktuara me nenin 46 paragrafi 1 dhe 3 nën paragrafi 3.3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ndërsa shkelja e ankuesit ka konsumuar elementet e përcaktuara me nenin 45 paragrafin 1 të ligjit material, ndërsa Vendimi i datës 10.08.2022 me numër:026 i Komisionit Disiplinor po ashtu është i ligjshëm edhe në kuptim të dispozitave ligjore të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, respektivisht i plotëson të gjitha kërkesat e përcaktuara me nenin 47 dhe 48 që duhet t'i ketë një akt administrativ, ndërsa Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues në kuptim të nenit 48 paragrafi 3, paragrafi 4 në paragrafi 4.1, paragrafi 6 dhe 7 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtar Publikë ka përmbushur detyrat dhe autorizimet që ia njeh ligji material, respektivisht në rastin konkret ka konstatuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike, ndërsa pretendimet ankimore të ankuesit janë të pabazuara.

Andaj, bazuar në këto rrethana dhe në mbështetje të nenit 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 si dhe nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.


KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
Lënda me numër A.nr.718/2022

Flakron GASHI

  
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Eshref SHABANI

  
Kryetar i Kolegjit

**Vendimi i dërgohet**

- Përfaqësuesit të ankuesit, Avokat [REDACTED]
- Drejtorit të Përgjithshëm në Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore të Shërbimit Korrektues të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.